



Manuali i instalimit

Kondicioneri Daikin për dhomë



FTXTP25M5V1B
FTXTP35M5V1B
FTXTP25N5V1B
FTXTP35N5V1B

Manuali i instalimit
Kondicioneri Daikin për dhomë

Shqip

EU – Safety declaration of conformity	UE – Déclaration de conformité	EU – Safety declaration of conformity	UE – Déclaration de conformité sobre seguridad	EC – Завершение о соответствии требованиям по безопасности	EU – Samsværserklæring for sikkerhet	EU – Izjava o skladnosti za sigurnost	EU – Varnostna izjava o skladnosti	EC – Декларация за съответствие за безопасност
EU – Sicherheits-Konformitätserklärung	UE – Dichiarazione di conformità in materia di sicurezza	EU – Sicherheits-Konformitätserklärung	UE – Dichiarazione di conformità in materia di sicurezza	EU – Turvallisuuden vaatimustenmukaisuusvakuutus	EU – Turvallisuuden vaatimustenmukaisuusvakuutus	EU – Beträktad säkerhets- och kvalitetsdeklaration	EU – Ouduste avalistuse deklaratsioon	ES – Diklaratsiun za sigurnost i bezbednost
EU – Declaration de conformité de sécurité	EE – Auhutusohuvõttevõtte, mis puudutab turvalisust	EU – Sicherheits-Übereinstimmungserklärung	EE – Auhutusohuvõttevõtte, mis puudutab turvalisust	EU – Bepoortingsproklamaatsiooni o sõltu	EU – Bepoortingsproklamaatsiooni o sõltu	UE – Déclaration zгодности с требованиями безопасности	EU – Deklaracija o zгодnosti s zahtevima za bezbednost	ES – Diklaratsiun o zгодnosti s zahtevima za bezbednost
EU – Conformitetserklæring vedligehold	UE – Déclaration de conformité relative à la sécurité	EU – Konformitetsdeklaration for sikkerhet	UE – Déclaration de conformité relative à la sécurité	EU – Konformitetsdeklaration for sikkerhet	EU – Konformitetsdeklaration for sikkerhet	UE – Declaratie de conformitate de siguranță	EU – Deklaracija o konformnosti s zahtevima za bezbednost	AB – Givemål utgörelse bekräftat

Daikin Europe N.V.

- decides under the sole responsibility that the products to which this declaration relates:
 erklärt in alleiniger Verantwortung, dass die Produkte, auf die diese Erklärung bezieht:
 décide sous la seule responsabilité que les produits pour lesquels cette déclaration
 verklaart heeft op eigen verantwoordelijkheid dat de producten waarvan deze verklaring
 declara bajo su única responsabilidad que los productos a los que hace referencia esta declaración
 dichiara sotto la propria responsabilità che i prodotti a cui si riferisce questa dichiarazione
 belyser under sin alene ansvar, at produktene som denne erklæring angår, er fremstillet af
 decara sub exclusivă responsabilitate, că produsele la care se referă această declarație sunt:

ATXTP25M5V1B, ATXTP35M5V1B, FTXTP25M5V1B, FTXTP35M5V1B,

- 01 are in conformity with the following directive(s) or regulation(s), provided that the products are used in accordance with our instructions:
02
03 folgende in Richtlinie oder Verordnung, vorausgesetzt, dass das gemäß unserer Anweisungen verwendet werden:
04 son conformes à la(ux) directive(s) ou règlement(s) ci(s) suivant(s), à condition que les produits soient utilisés conformément à nos instructions:
05 in overeenstemming met de volgende richtlijn(en) of verordening(en), op voorwaarde dat de producten worden gebruikt overeenkomstig onze
06 instructies:
07 están en conformidad con la(s) siguiente(s) directiva(s) o reglamento(s), siempre que se utilicen de acuerdo con nuestras instrucciones:
08 estão em conformidade com a(s) seguinte(s) diretiva(s) ou regulamento(s), desde que os produtos sejam utilizados de acordo com as nossas
09 instruções:

Machinery 2006/42/EC**

Low Voltage 2014/35/EU

Electromagnetic Compatibility 2014/30/EU*

- | | | | |
|----|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 01 | following the provisions of: | 01 | underlagt bestemmelsen af: |
| 02 | gemäß den Bestimmungen in: | 10 | under bestemmelserne for: |
| 03 | conformément aux dispositions de: | 11 | ihindhold 1 bestemmelse: |
| 04 | conformément aux dispositions de: | 12 | ihindhold 1 bestemmelse: |
| 05 | selv efter de dispositioner de: | 13 | noudatidaen sammekøst: |
| 06 | volgens de bepalingen van: | 14 | toe toedien gebruik over: |
| 07 | selv efter de dispositioner de: | 15 | toe toedien gebruik over: |
| 08 | conformément aux dispositions de: | 16 | forord 122: |
| 09 | conformément aux dispositions de: | 17 | zborné zoznamoviam: |
| 10 | conformément aux dispositions de: | 18 | urnándi prevetör: |

- 01 Note* as set out in <> and judged positively by <> according to the **Certificat** <>
 02 Hinweis* wie in <> aufgeführt und von <> positiv beurteilt gemäß **Zertifikat** <>
 03 Remarque* telles que définies dans <> et évaluées positivement par <> conformément au **Certificat** <>
 04 Bemerk* zoals uiteenzet in <> en positief beoordeeld door <> overeenkomstig het **Certificaat** <>
 05 Nota* ta como se establece en <> y valorado positivamente por <> de acuerdo con el **Certificado** <>

- 01** Dairin Europe N.V. is authorised to compile the Technical Construction File.
02** Dairin Europe N.V. hat die Berechtigung die Technische Konstruktionsakte zusammenzustellen.
03** Dairin Europe N.V. est autorisée à compiler le Dossier de Construction Technique.
04** Dairin Europe N.V. is bevoegd om het Technisch Constructiedossier samen te stellen.
05** Dairin Europe N.V. está autorizado a compilar el Archivo de Construcción Técnica.
06** Dairin Europe N.V. è autorizzata a redigere il File tecnico di Costruzione.

- 07** H Daikin Europe N.V., eiðva
08** A Daikin Europe N.V. está
09** Компания Даikin Europe N
10** Daikin Europe N.V. er auto
11** Daikin Europe N.V. ár bem
12** Daikin Europe N.V. har tila

- 01 as amended,
02 in der jeweils gültigen Fassung,
03 telles que modifiées,
04 zoals gewijzigd,
05 en su forma enmendada,
06 e successive modifiée,
07 ότως έχουν τροποποιηθεί,

- 08 conforme emendado,
09 в действующей редакции,
10 som tilføjet,
11 med tilføj,
12 med forelæte endringer,
13 sellesina kuin ne ovat muutettuina,

- 20 koos muudatuslega,
21 с техните изменения
22 ир jos tolesnes redakc
23 ar grozījumiem,
24 v poslednom platnom
25 deģistrīdīģi šķēīyle,

EN 60335-2-40,

- 16 Meglegyzás
som angles in <4> oči godišans ar <6> enligt
Sertifikat <4>
- 17 Uvaga*
som det tenk kommer i <4> og vurder positivt ar
<6> i henhold til Sertifikat <4>
- 18 Nota*
selaissuun huiv ne on esitely asajirassa <4> ja
joka <6> on kytynyt Sertifikaattiin <4>
mukaisesti.
- 19 Opomba*
ja bylo uvećeno v <4> a pozitivně zjištěno <6>
- 20 Märkus*
v sulaati. <4> Osvedčeniim <4>
kakto je izloženo v <4> pozitivno ocenjeno od
<6> prema Sertifikatu <4>

- | | | | |
|----|------------|----|------------|
| 21 | 3afoenaxna | 21 | 3afoenaxna |
| 22 | Pastaba* | 22 | Pastaba* |
| 23 | Pezimes* | 23 | Pezimes* |
| 24 | Poznamka* | 24 | Poznamka* |
| 25 | Not* | 25 | Not* |

- [illegible]

- 19^{††} 20^{††} 21^{††} 22^{††} 23^{††} 24^{††} 25^{††}

- 19th Dakin Europe N.V. je podlažan za sestavo datotek s tehnično mapo.
- 20th Dakin Europe N.V. on volatlu koostama tehniisi dokumentatsioni.
- 21st Dakin Europe N.V. e otprizimljena de cstanja Arta za teknična konstrukcija.
- 22nd Dakin Europe N.V. yra gajola sudaviti s tehničnis konstrukcijs faila.
- 23rd Dakin Europe N.V. ir autorizės sasiiati tehniisi dokumentacijai.
- 24th Spolėtnost' Dakin Europe N.V. je opieriamia vyvonioti sior technickej konstrukcije.
- 25th Dakin Europe N.V. Teknik Yaui Dosyimas derlemeve veiklidi.

- EC – Декларация за съответствие за безопасност
ES – Drošības atbilstības deklarācija
EU – Vyhlásenie o zhode Bezpečnosť
AB – Güvenlik uygunluk beyanı

- [illegible]

- [illegible]

- 14 v platném znění,
15 jako je zmíněno amandmanima,
16 és módosítások rendelkezéseit,
17 z późniejszymi zmianami,
18 cu amendamentele respective,
19 kakor je bilo spreminjeno,

- vydání,

- 13st Daikin Europe N.V. on valitud teadmiste ja teadmiste oskuste arendamiseks.
- 14st Společnost Daikin Europe N.V. má oprávnění ke kompilaci, současně
- 15st Daikin Europe N.V. je ověřen za zřadu Datatek o technický kolektiv.
- 16st Daikin Europe N.V. jogsullat mészaki konstrukciós dokumentumok
- 17st Daikin Europe N.V. ma upowaznienie do zbierania i opracowywania
- 18st Daikin Europe N.V. este autorizat să compileze Documentul tehnic de

- ...ru technické konstrukce.
...strukcji.
...ció összeállítására.
...nia dokumentációj konstrukcióját.
...e konstrukció.

- | | |
|------------------|---|
| 19 th | Daklin Evropske NV, je pobližšen za sestavo datoteke s tehnično napo. |
| 20 th | Daklin Evropske NV, on vlogi kosičena tehnični dokumentaci. |
| 21 st | Daklin Evropske NV, je organizirana da sestavi Arta za tehnična vna. |
| 22 nd | Daklin Evropske NV, vra gajba sudarj s tehničnih konstrukcijskila. |
| 23 rd | Daklin Evropske NV, je avtorizeti sestajati tehniško dokumentaci. |
| 24 th | Splošnost Daklin Evropske NV, je pravičnari vneti slobi tehničdeli ko |
| 25 th | Daklin Evropske NV, Teknič Vpi. Dosyevim delenimve vektir. |

 **DAIKIN EUROPE N.V.**
Hiromitsu Iwasaki
Director
Ostend, 1st of December 2022
Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

UKCA – Safety declaration of conformity

Daikin Europe N.V.

declares under its sole responsibility that the products to which this declaration relates:

ATXTP25M5V1B, ATXTP35M5V1B, FTXTP25M5V1B, FTXTP35M5V1B,

are in conformity with the following directive(s) or regulation(s), provided that the products are used in accordance with our instructions:

- S.I. 2008/1597: Supply of Machinery (Safety) Regulations 2008**
- S.I. 2016/1101: Electrical Equipment (Safety) Regulations 2016
- S.I. 2016/1091: Electromagnetic Compatibility Regulations 2016*

as amended,

following the provisions of: BS EN 60335-2-40,

* as set out in <A> and judged positively by according to the **Certificate <C>**.

** Daikin Europe N.V. is authorised to compile the Technical Construction File.

<A>	DAIKIN.TCF.032E12/06-2021
	—
<C>	—

UKCA – Safety declaration of conformity

Daikin Europe N.V.

declares under its sole responsibility that the products to which this declaration relates:

FTXTP25N5V1B, FTXTP35N5V1B,

are in conformity with the following directive(s) or regulation(s), provided that the products are used in accordance with our instructions:

- S.I. 2008/1597: Supply of Machinery (Safety) Regulations 2008**
- S.I. 2016/1101: Electrical Equipment (Safety) Regulations 2016
- S.I. 2016/1091: Electromagnetic Compatibility Regulations 2016*

as amended,

following the provisions of: BS EN 60335-2-40,

* as set out in <A> and judged positively by according to the **Certificate <C>**.

** Daikin Europe N.V. is authorised to compile the Technical Construction File.

<A>	DAIKIN.TCF.032F02/06-2023
	—
<C>	—

Tabela e përmbajtjes

1 Rreth dokumentacionit	6
1.1 Rreth këtij dokumenti.....	6
2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit	7
3 Rreth kutisë	8
3.1 Njësia e brendshme	8
3.1.1 Heqja e aksesoreve nga njësia e brendshme	8
4 Rreth njësive	8
4.1 Rreth LAN-it me valë	8
4.1.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë	8
4.1.2 Parametrat bazë	8
5 Instalimi i njësive	8
5.1 Përgatitja e vendit të instalimit.....	8
5.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësine e brendshme	8
5.2 Montimi i njësive së brendshme	9
5.2.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit	9
5.2.2 Si të shpini një vrimë në mur	9
5.2.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit	10
5.3 Lidhja e tubacionit të kullimit	10
5.3.1 Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas.....	10
5.3.2 Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas.....	10
5.3.3 Kontrolli për rrjedhje uji	10
6 Instalimi i tubacionit	11
6.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit	11
6.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit	11
6.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit	11
6.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit	11
6.2.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësine e brendshme	11
6.2.2 Për të kontrolluar nyjat e tubacionit të ftohësit për rrjedhje pas ngarkimit të ftohësit	11
7 Instalimi elektrik	12
7.1 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike...	12
7.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësine e brendshme	12
8 Përfundimi i instalimit të njësive së brendshme	13
8.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kablos së ndërlidhjes	13
8.2 Kalimi i tubave ftohësit përmes vrimës së murit	13
8.3 Fiksimi i njësive mbi pllakën e montimit	13
9 Instalimi i përshtatës uajrlës LAN	14
9.1 Instalimi i përshtatës	14
9.1.1 Për të lidhur përshtatësin me njësine.....	14
9.1.2 Vendosni përshtatësin në njësi	14
9.1.3 Kontrollimi i funksionalitetit të përshtatës	15
9.2 Rregullimi i LAN-it me valë	15
9.2.1 Instalimi i aplikacionit ONECTA	15
10 Konfigurimi	15
11 Vënia në punë	15
11.1 Lista e plotë para komisionimit	15
11.2 Kryerja e një testimi	16
11.2.1 Kryerja e një ekzekutim testimi në sezonin e dimrit	16
12 Hedhja	16
13 Të dhënat teknike	16

13.1 Skema e instalimeve elektrike	16
13.1.1 Legjenda e unifikuar e skemës së instalimeve elektrike	16

1 Rreth dokumentacionit

1.1 Rreth këtij dokumenti



PARALAJMËRIM

Sigurohuni që instalimi, servisi, mirëmbajtja, riparimi dhe materialet e përdorura ndjekin udhëzimet nga Daikin (duke përfshirë të gjitha dokumentet e renditura në "Seti i dokumentacionit") dhe, për më tepër, përputhen me legjislacionin e aplikueshëm dhe kryhen vetëm nga persona të kualifikuar. Në Evropë dhe zona ku zbatohen standardet IEC, EN/IEC 60335-2-40 është standardi i aplikueshëm.



INFORMACION

Kontrolloni që përdoruesi e ka dokumentacionin të printuar dhe kërkojini që ta mbajë për referencë në të ardhmen.

Audienca e synuar

Instaluesit e autorizuar



INFORMACION

Qëllimi i kësaj pajisjeje është përdorimi nga përdoruesit ekspertë ose të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar ose shtëpiak nga jo profesionistë.

Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:**
 - Udhëzimet që DUHET të lexoni mbi sigurinë para instalimit
 - Format: Letër (te kutia e njësive së brendshme)
- **Manuali i instalimit të njësive së brendshme:**
 - Udhëzimet e instalimit
 - Format: Letër (te kutia e njësive së brendshme)
- **Udhëzuesi referencë i instaluesit:**
 - Përgatitja e instalimit, praktikat e mira, të dhënat referencë,...
 - Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit 🔍 për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimi më i fundit i dokumentacionit të dhënë botohet në faqen rajonale Daikin të internetit dhe vihet në dispozicion përmes shitësit tuaj.

Skanoni kodin QR më poshtë për të gjetur setin e dokumentacionit të plotë dhe më shumë informacion rreth produktit tuaj në uebfaqen e Daikin.

FTXTP-M



FTXTP-N



Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

Të dhënat inxhinierike teknike

- Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- **Grupi i plotë** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

2 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

Instalimi i njësive (shihni **"5 Instalimi i njësive"** ▶ 8))



PARALAJMËRIM

Instalimi duhet të kryhet nga një instalues, zgjedhja e materialeve dhe instalimi duhet të përputhet me legjislacionin e zbatueshëm. Në Evropë, EN378 është standardi i zbatueshëm.



PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune). Madhësia e dhomës duhet të jetë siç specifikohet në masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë.



KUJDES

Për muret që përmbajnë një kornizë ose dërrasë metalike, përdorni një tub të futur në mur dhe veshje muri të mekanizmi i furnizimit përmes vrimës për të parandaluar një nxehtësi të mundshme, shok elektrik apo zjarr.

Instalimi i tubacionit (shihni **"6 Instalimi i tubacionit"** ▶ 11))



KUJDES

Tubacioni dhe nyjat e bashkimit të një sistemi të ndarë do të kryhen me nyja të përhershme kur të jenë brenda një hapësire të zënë përveç nyjave që lidhin tubacionin me njësitet e brendshme.



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE/PËRVËLIMI



KUJDES

- Ngjeshja e paplotë mund të shkaktojë rrjedhje të gazit të ftohës.
- MOS ripërdorni ngjeshje. Përdor ngjeshje të reja për të parandaluar rrjedhjen e gazit të ftohës.
- Përdorni dado ngjeshëse që përfshihen me njësine. Përdorimi i dadove të ndryshme ngjeshëse mund të shkaktojë rrjedhjen e gazit të ftohës.

Instalimi elektrik (shihni **"7 Instalimi elektrik"** ▶ 12))



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kablo me shumë bërthama për kablot e furnizimit me energji elektrike.



PARALAJMËRIM

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një elektricist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjislacionin në fuqi.



PARALAJMËRIM

- Nëse furnizimit me energji elektrike i mungon faza-N ose është e gabuar, pajisja mund të prishet.
- Vendos tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësine të tubat e shërbimeve utilitare, përthithësi i fryrjeve apo tokëzimet e telefonit. Tokëzimi i paplotë mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instalo siguresat e kërkuara ose siguresat e qarkut.
- Siguroji instalimet elektrike me lidhëse kabllorsh që kablot të mos bin në kontakt me tehet e mprehta apo tubacionin, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS përdorni tela të ngjitur, kordona zgjatues ose lidhje nga një sistem yjesh. Ato mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.
- MOS e instaloni kondensatorin për përparimin e fazës, sepse kjo pajisje është e pajisur me një inverter. Kondensatori për përparimin e fazës ul performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.



PARALAJMËRIM

Përdorni një lloj çelësi për ndërprerje me të gjitha polet me të paktën 3 mm mes hapësirave të pikës së kontaktit që ofron ndërprerje të plotë sipas kategorisë III të mbitensionit.



PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.



PARALAJMËRIM

MOS e lidhni furnizimin e energjisë me njësine e brendshme. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



PARALAJMËRIM

- MOS përdorni pjesë elektrike të blera lokalisht brenda produktit.
- MOS e degëzoni furnizimin me energji elektrike për pompën e kullimit, etj. nga blloku terminal. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



PARALAJMËRIM

Sistemin e instalimit të ndërlidhjes mbajeni larg tubave të bakrit pa izolim termal, sepse mund të jenë shumë të nxehta.

Instalimi i përshtatës uajrles LAN (shikoni **"9 Instalimi i përshtatës uajrles LAN"** ▶ 14))



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

- Fikni furnizimin me energji para instalimit të përshtatës.
- MOS e përdorni përshtatësin me duar të lagura.
- MOS e lini përshtatësin të laget.
- MOS e çmontoni, modifikoni apo riparoni përshtatësin.
- Kapni lidhësin kur shkëputni kordonin e lidhjes.
- FIKNI energjinë në rast se dëmtohet përshtatësi.

3 Rreth kutisë


3 Rreth kutisë

3.1 Njësia e brendshme

3.1.1 Heqja e aksesorëve nga njësia e brendshme

1 Hiqni:

- qesen e aksesorëve që gjendet në fund të paketimit,
- plakën e montimit bashkëngjitur pjesës së pasme të njësisë së brendshme.



- a Manuali i instalimit
- b Manuali i përdorimit
- c Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë
- d Filtri aromatizues i apatitit prej titani dhe filtri argjend i pastrimit (filtri Ag-ion)
- e Vidha e montimit të njësisë së brendshme (M4×12L). Referojuni "8.3 Fiksimi i njësisë mbi plakën e montimit" [p. 13].
- f Bateria e thatë AAA.LR03 (alkali) për ndërfaqen e përdoruesit
- g Zotëruesi i ndërfaqes së përdoruesit
- h Ndërfaqja e përdoruesit
- i Plaka e montimit
- j Përshtatësi uajrles LAN

4 Rreth njësisë



ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

4.1 Rreth LAN-it me valë

- Përshtatësi uajrles LAN është pjesë qese së aksesorëve.

Për specifikimet e detajuara, udhëzimet e instalimit, metodat e cilësimit, pyetjet e shpeshta FAQ, deklaratën e pajtueshmërisë dhe versionin e fundit të këtij manuali, vizitoni app.daikineurope.com.



INFORMACION: Deklarata e pajtueshmërisë

- Daikin Industries Czech Republic s.r.o. deklaron se lloji i pajisjes së radios brenda kësaj njësie është në pajtim me Direktivën 2014/53/EU dhe S.I. 2017/1206: Rregulloret e Pajisjeve të Radios 2017.
- Kjo njësi konsiderohet si pajisje e kombinuar në përputhje me përkufizimin e Direktivës 2014/53/EU dhe S.I. 2017/1206: Rregulloret e Pajisjeve të Radios 2017.



INFORMACION

Instaloni përshtatësin e uajrlesit LAN pas përfundimit të instalimit të njësisë së brendshme. Referojuni "9 Instalimi i përshtatësit uajrles LAN" [p. 14].

4.1.1 Masat paraprake kur përdorni LAN-in me valë

MOS e përdorni afër:

- Pajisjeve mjekësore.** P.sh. personave që përdorin stimules kardiakë ose defibrilatorë. Ky produkt mund të shkaktojë interferencë elektromagnetike.
- Pajisjeve me kontroll automatik.** P.sh. dyerve automatike ose pajisjeve të alarmit të zjarrit. Ky produkt mund të shkaktojë defekte të pajisjes.
- Mikrovalës.** Mund të ndikojë te komunikimet uajrles LAN.

4.1.2 Parametrat bazë

Çfarë	Vlera
Fusha e frekuencës	2400 MHz~2483.5 MHz
Protokolli i radios	IEEE 802.11b/g/n
Kanali i frekuencës së radios	1~11
Energjia output	0 dBm~18 dBm
Energjia efektive e rrezatuar	17 dBm (11b) / 13 dBm (11g) / 12 dBm (11n)
Furnizimi me energji	DC 14 V / 100 mA

5 Instalimi i njësisë



INFORMACION

Nëse nuk jeni të sigurt si të hapni ose mbyllni pjesë të njësisë (panelin e përparmë, kasën e instalimeve elektrike, skarën e përparme...) referojuni udhëzuesin referencë të instaluesit të njësisë për procedurat e hapjes dhe mbylljes. Për vendndodhjen e udhëzuesit referencë të instaluesit, shikoni "1.1 Rreth këtij dokumenti" [p. 6].



PARALAJMËRIM

Instalimi duhet të kryhet nga një instalues, zgjedhja e materialeve dhe instalimi duhet të përputhet me legjislacionin e zbatueshëm. Në Evropë, EN378 është standardi i zbatueshëm.

5.1 Përgatitja e vendit të instalimit



PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune). Madhësia e dhomës duhet të jetë siç specifikohet në masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë.

5.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme




INFORMACION

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

- Rryma e ajrit.** Sigurohu që asgjë të mos bllokojë rrymën e ajrit.
- Kullimi.** Sigurohu që uji i kondensuar mund të hiqet siç duhet.
- Izolimi i murit.** Kur kushtet në mur kalojnë 30°C dhe kur në mur vendoset një lagështi relative prej 80% ose ajër i freskët, atëherë kërkohet izolimi shtesë (minimumi 10 mm trashësi, sfungjer polietileni).

- **Forca e murit.** Kontrolloni nëse muri ose dyshemeja janë të qëndrueshëm për të mbështetur peshën e njësisë. Nëse ka rrezik, përforconi murin ose dyshemën për ta instalimit të njësisë.
- **Hapësira.** Instaloni njësinë të paktën 1,8 m nga dyshemeja dhe mbani parasysh këto kërkesa për distancat nga muret dhe tavani:




5.2 Montimi i njësisë së brendshme

5.2.1 Ri-instalimi i pllakës së montimit


- 1** Instalimi i përkohshëm i pllakës së montimit.

- 2 Niveloni pllakën e montimit.
- 3 Shënoni qendrat e pikave të shpimit në mur duke përdorur një matës. Vendoseni metrin matës te simboli "▷".
- 4 Mbaroni instalimin duke siguruar pllakën e montimit në mur duke përdorur vidha M4×25L (furnizuar nga klienti).



INFORMACION

Kapaku i portës së tubit të hequr mund të mbahet në një xhiep të pllakës së montimit.



- a Pikat e fiksimit të pllakës së montimit të rekomanduar
- b Xhep për kapakun e portës së tubit
- c Fundi i tubit të lëngjeve
- d Fundi i tubit të gazrave
- e Përdorni matës siç tregohet
- f Mbjatëset për vendosjen e një niveluesi
- g Qendra e njësisë
- h Vrima për tubacionin e montuar Ø65 mm

- i1 Qendra e vrimës së tubacionit: 160 mm në të majtë
j2 Qendra e vrimës së tubacionit: 170 mm për të djathtë
j Pozicioni për metrin të simboli ">"
k Për fundin e tubit FTXTP përdorni etiketimin "L" dhe "G"
l Gjatësia e tubacionit të gazrave
m Gjatësia e tubacionit të lëngjeve
n Gjatësia e zorrës së kullimit
o Konturi i njësisë

5.2.2 Si të shponi një vrimë në mur



KUJDES


Për muret që përmbajnë një kornizë ose dërrasë metalike, përdorni një tub të futur në mur dhe veshje muri të mekanizmit i furnizimit përmes vrimës për të parandaluar një nxehtësi të mundshme, shok elektrik apo zjarr.



NJOFTIM

Sigurohuni të izoloni boshllëqet përreth tubave me material izolues (siguruar nga instaluesi) për të parandaluar rrjedhjen e ujit.

- 1** Hapni një mekanizëm furnizimi 65 mm të madh përmes vrimës në mur me një pjerrësi tatëpjetë drejt pjesës së jashtme.
- 2** Vendosni një tub muri të futur në vrimë.
- 3** Vendosni një veshje muri në tubin e murit.



5 Instalimi i njësisë

- a Tubacioni i futur në mur
- b Stuko
- c Kapaku i vrimës së murit

- 4 Pas përfundimit të instalimeve, vendosjes së tubacionit të ftohësit dhe kullimit, MOS harroni të izoloni boshllëkun me stuko.


5.2.3 Si të hiqni kapakun e portës së tubit




INFORMACION

Për të lidhur tubacionin në krahun e djathtë, në fund djathtas, në krahun e majtës ose në fund majtas, kapaku i portës së tubit DUHET të hiqet.

- 1 Prisni kapakun e portës së tubit nga brenda rrjetës së përparme duke përdorur një sharrë në formë U-je.



- 2 Hiqni çdo rrudhje përgjatë pjesës së prerjes duke përdorur një limë gjilpërë gjysmë të rumbullakët.



NJOFTIM

MOS përdorni pinca për të hequr kapakun e portës së tubit, sepse kjo do të dëmtonte rrjetën e përparme.

5.3 Lidhja e tubacionit të kullimit


5.3.1 Lidhja e tubacionit në krahun e djathtë, në pjesën e pasme ose fundore djathtas



INFORMACION

Kur del nga fabrika tubacioni është nga krahu i djathtë. Për tubacionin e krahut të majtë, hiqni tubacionin nga ana e djathtë dhe instalojeni në anën e majtë.

- 1 Ngjitni zorrën e kullimit me ngjitës adeziv te fundi i tubave të ftohësit.
- 2 Mbështilleni bashkë zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit duke përdorur izolant.



- A Tubacioni i krahut të djathtë
- B Tubacioni fundor djathtas

- C Tubacioni fundor prapa
- a Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të djathtë
- b Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin fundor

5.3.2 Lidhja e tubacionit në krahun e majtë, në pjesën e pasme ose fundore majtas



INFORMACION

Kur del nga fabrika tubacioni është nga krahu i djathtë. Për tubacionin e krahut të majtë, hiqni tubacionin nga ana e djathtë dhe instalojeni në anën e majtë.


- 1 Hiqni vidhën e fiksimit të izolimit në krahun e djathtë dhe hiqni zorrën e kullimit.
- 2 Hiqni kandelën e kullimit në anën e majtë dhe ngjitni me anën e djathtë.



NJOFTIM


MOS përdorni vaj lubrifikues (vaj ftohësi) në kandelën e kullimit kur e vendosni brenda. Kandelja e kullimit mund të përkeqësohet dhe shkaktojë rrjedhje kullimi nga kandelja.

- 3 Vendosni zorrën e kullimit në krahun e majtë dhe mos harroni ta shtërngoni me vidhën e fiksimit; përndryshe mund të ketë rrjedhje uji.



- a Vidha e fiksimit të izolimit
- b Zorra e kullimit


- 4 Ngjitni zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit nga ana fundore duke përdorur izolant.



- A Tubacioni i krahut të majtë
- B Tubacioni prapa majtas
- C Tubacioni fundor majtas
- a Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të majtë
- b Hiqni kapakun e portës së tubit këtu për tubacionin e krahut të majtë në fund

5.3.3 Kontrolli për rrjedhje uji

- 1 Hiqni filtrat e ajrit.
- 2 Hidhni ngadalë rreth 1 l ujë në tabakanë e kullimit dhe kontrolloni për rrjedhje uji.



6 Instalimi i tubacionit

6.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit

6.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit



KUJDES

Tubacioni dhe nyjat e bashkimit të një sistemi të ndarë do të kryhen me nyja të përhershme kur të jenë brenda një hapësire të zënë përveç nyjave që lidhin tubacionin me njësitë e brendshme.



NJOFTIM

Tubacioni dhe pjesë të tjera presioni do të jenë të përshtatshme për ftohësin. Përdorni bakër fosforik dhe deoksidues pa shtresa për tubacionin e ftohësit.

- Materialët e huaja brenda tubave (përfshirë vajrat për fabrikimin) duhet të jenë ≤ 30 mg/10 m.

Diametri i tubacionit të ftohësit

Përdorni të njëjtat diametra si lidhjet te njësia e jashtme:

Tubacioni i lëngjeve	Tubacioni i gazrave
$\varnothing 6,4$ mm	$\varnothing 9,5$ mm

Materiali i tubacionit të ftohësit

- Materiali i tubacionit:** bakër fosforik dhe deoksidues pa shtresa për e ftohësit
- Lidhjet me ngjeshje:** Përdor vetëm material të kalitur.
- Shkalla e kalitjes dhe trashësia e tubacioneve:**

Diametri periferik ($\varnothing$)	Shkalla e kalitjes	Trashësia (t) ^(a)	
6,4 mm (1/4")	Kalitur (O)	$\geq 0,8$ mm	
9,5 mm (3/8")	Kalitur (O)		

^(a) Në varësi të legjislacionit në fuqi dhe presionit maksimal në gjendje të punë të njësive (shihni "PS High" te pllaka e emrit të njësive), mund të kërkohej një trashësi më e madhe e tubacionit.

6.1.2 Izolimi i tubacionit të ftohësit

- Përdor sfungjer polietileni si material izolimi:
 - me një shkallë transferimi të nxehtësisë mes 0,041 dhe 0,052 W/mK (0,035 dhe 0,045 kcal/mh°C)
 - me një rezistencë ndaj ngrohjes prej të paktën 120°C
- Trashësia e izolimit:

Diametri periferik i tubit ($\varnothing_p$)	Diametri i brendshëm i izolimit ($\varnothing_i$)	Trashësia e izolimit (t)
6,4 mm (1/4")	8~10 mm	≥ 10 mm
9,5 mm (3/8")	10~14 mm	≥ 13 mm



Nëse temperatura është më e lartë se 30°C dhe lagështia është më e madhe se RH 80% (lagështia relative), trashësia e materialeve të izolimit duhet të jetë të paktën 20 mm për të parandaluar kondensimin mbi sipërfaqen e izolimit.

6.2 Lidhja e tubacionit të ftohësit



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE/PËRVËLIMI

6.2.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësine e brendshme




ALARM: MATERIAL QË NDIZET LEHTË

Ftohësi brenda kësaj njësie digjet lehtësisht.

- Gjatësia e tubit.** Mbajeni tubacionin e ftohësit sa më të shkurtër të jetë e mundur.

- Lidhni tubacionin e ftohësit me njësine duke përdorur **lidhjet e telit të zgjeruar**.
- Mbështillni lidhjen e tubit të ftohësit duke përdorur ngjitëse vinil, duke përkuar pjesërisht të paktën gjysmën e gjerësisë së ngjitëses me secilën radhë. Mbani të mbuluar çarjen e tubit të izolimit të nxehtësisë. Shmangni mbështjelljen e fortë të ngjitëses.



- Kapaku i tubit të izolimit të nxehtësisë (në anën e njësive së brendshme)
- Lidhjet e telit të zgjeruar
- Tubi i lëngjeve (me izolim) (siguruar nga klienti)
- Tubi i gazrave (me izolim) (siguruar nga klienti)
- Çarja në kapakun e tubit të izolimit të nxehtësisë me fytyrë nga lart
- Ngjitëse vinili (siguruar nga klienti)

- Izoloni** tubacionin e ftohësit, kabllon e ndërlidhjes dhe zorrën e kullimit te njësia e brendshme: Shikoni "8.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kabllor së ndërlidhjes" [p. 13].



NJOFTIM

Sigurohu të izolosh të gjithë tubacionin e ftohësit. Çdo tubacion i ekspozuar mund të shkaktojë kondensim.

6.2.2 Për të kontrolluar nyjat e tubacionit të ftohësit për rrjedhje pas ngarkimit të ftohësit

- Kryeni testimet për rrjedhje sipas udhëzimeve në instalim manualin për instalimin e njësive së jashtme.
- Ngarkoni ftohësin.
- kontrolloni për rrjedhje të ftohësit pas ngarkimit (shikoni më poshtë).

7 Instalimi elektrik

Testim për nyjat e ftohësit përgatitur në terren për njësitë e brendshme

- 1 Përdorni një metodë të testimit të rrjedhjes me një ndjeshmëri minimale prej 5 g të ftohësit në vit. Testoni rrjedhjet duke përdorur një presion prej të paktën 0,25 herë maksimumin e presionit funksional (shiko "PS High" në pllakën metalike të njësisë).

Nëse zbulohet një rrjedhje

- 1 Rikuperoni ftohësin, riparoni nyjën dhe përsëritni testimin.

7 Instalimi elektrik



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kablo me shumë bërthama për kabllo të furnizimit me energji elektrike.



PARALAJMËRIM

Përdorni një lloj çelësi për ndërprerje me të gjitha polet me të paktën 3 mm mes hapësirave të pikës së kontaktit që ofron ndërprerje të plotë sipas kategorisë III të mbitensionit.



PARALAJMËRIM

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.



PARALAJMËRIM

MOS e lidhni furnizimin e energjisë me njësinë e brendshme. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



PARALAJMËRIM

- MOS përdorni pjesë elektrike të blera lokalisht brenda produktit.
- MOS e degëzoni furnizimin me energji elektrike për pompën e kullimit, etj. nga blloku terminal. Kjo mund të rezultojë në shok elektrik ose zjarr.



PARALAJMËRIM

Sistemin e instalimit të ndërlidhjes mbajeni larg tubave të bakrit pa izolim termal, sepse mund të jenë shumë të nxehta.

7.1 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike



NJOFTIM

Rekomandojmë përdorimin e telave të fortë (tek bërthamë). Nëse përdoren telat e bllokuar, rrotulloni ngadalë telat për të konsoliduar fundin e përçuesin për secilin prej përdorim të drejtpërdrejtë në kapësen e terminalit ose vendosjen në një terminal të rrumbullakët të llojit dredhë. Detajet përshkruhen në "Udhëzimet kur bëni lidhjen e instalimeve elektrike" në udhëzuesin referencë të instaluesit.

Përbërësi		
Kabloja e ndërlidhjes (brenda↔jashtë)	Voltazhi	220~240 V
	Madhësia e telit	Përdorni vetëm tel të harmonizuar që ofrojnë izolim të dyfishtë dhe janë të përshtatshëm për voltazhin në përdorim Kablo me 4 bërthama 1,5 mm ² ~2,5 mm ² (bazuar në njësinë e jashtme)

7.2 Lidhja e instalimeve elektrike me njësinë e brendshme



PARALAJMËRIM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.




NJOFTIM

- Mbani linjën e energjisë dhe të transmetimit të ndarë nga njëra-tjetra. Instalimet elektrike të transmetimit dhe furnizimi me energji elektrike mund të kryqëzohen, por NUK mund të punojnë paralel.
- Për të shmangur çdo lloj interferimi elektrik distanca mes të dy instalimeve duhet të jetë GJITHMONË të paktën 50 mm.

Punët elektrike duhen kryer në përputhje me manualin e i instalimit dhe rregullat kombëtare të instalimeve elektrike apo kodin e praktikës.

- 1 Vendoseni njësinë e brendshme në çengelët e pllakës së montimit. Përdorni shenjat "Δ" si udhëzues.




- a Pllaka e montimit (aksesor)
- b Kabloja e ndërlidhjes
- c Udhëzuesi i telit

- 2 Hapnin panelin para dhe pastaj kapakun e shërbimit. Referojuni udhëzuesit referencë të instaluesit për procedurën e hapjes. Për vendndodhjen e udhëzuesit referencë të instaluesit, referojuni "1 Rreth dokumentacionit" [p. 6].
- 3 Kaloni kabllo të ndërlidhjes nga njësia e jashtme përmes mekanizmit të furnizimit dhe vrima e murit, nëpërmjet pjesës prapa të njësisë së brendshme dhe nga ana para.


Shënim: Në rast se kabloja e ndërlidhjes është zhveshur përpara, mbuloni pjesën fundore me izolant.

- 4 Përkulni fundin e kabllos për lart.




- a Blloku i terminalit
- b Blloku i përbërësve elektrik
- c Kapësja e kabllos

- 5 Zhvishni rreth 15 mm pjesët fundore të telit.
- 6 Përshtatni ngjyrat e telit me numrat e terminalit në blloqet e terminalit të njësies së brendshme dhe vidhosni mirë telat me terminalet përkatëse.
- 7 Lidhni telin e tokëzimit me terminalin përkatës.
- 8 Fiksoni mirë telat me vidat e terminalit.
- 9 Tërhiqni telat për t'u siguruar që janë të ngjitur në mënyrë të sigurt, pastaj ruani telat me mbajtësen e telave.
- 10 Jepuni telave formë në mënyrë që kapaku i shërbimit të përputhet mirë, pastaj mbylleni atë.




8 Përfundimi i instalimit të njësies së brendshme

8.1 Izolimi i tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kablos së ndërlidhjes



- a Çarja
- b Kapaku i tubit të izolimit të nxehtësisë
- c Tubi i lëngjeve
- d Tubi i gazrave
- e Tubi i kullimit
- f Kabloja e ndërlidhjes
- g Izolant
- h Ngjithës vinili

- 1 Pas përfundimit të tubacionit të kullimit, të ftohësit dhe kablos së ndërlidhjes. Mbështillni bashkë tubat e ftohësit, kabllon e ndërlidhjes dhe zorrën e kullimit duke përdorur izolantin. Përkoni të paktën gjysmën e gjerësisë së ngjithëses nga secila radhë.




- a Zorra e kullimit
- b Kabloja e ndërlidhjes
- c Pllaka e montimit (aksesor)
- d Tubacioni i ftohësit

- e Vidha e montimit të njësies së brendshme M4×12L (aksesor)
- f Korniza fundore

8.2 Kalimi i tubave ftohësit përmes vrimës së murit

- 1 Rregulloni tubat e ftohësit përgjatë linjës së tubacionit në pllakën e montimit.




- a Zorra e kullimit
- b Stukoni vrimën me stuko ose material stukues
- c Ngjitës adeziv
- d Izolant
- e Pllaka e montimit (aksesor)



NJOFTIM


- MOS i përkulni tubat e ftohësit.
- MOS i shtyni tubat e ftohësit brenda kornizës fundore ose rrjetës së përparme.



- 2 Kalojeni zorrën e kullimit dhe tubat e ftohësit përmes vrimës së murit dhe boshllëkun izolojeni me stuko.

8.3 Fiksimi i njësies mbi pllakën e montimit

- 1 Vendoseni njësine e brendshme mbi mbajtëset e pllakës së montimit. Përdorni shënimet "△" si udhëzues.



- 2 Shtypni kornizën fundore të njësies me të dy duart për ta vendosur mbi gremçat fundorë të montimit. Sigurohuni që telat NUK ngjeshen kund.

Shënim: Siguroni që kabloja e ndërlidhjes NUK kapet te njësia e brendshme.

- 3 Shtypni buzën fundore të njësies së brendshme të dy duart derisa të kapet mirë nga gremçat e pllakës së montimit.

- 4 Siguroni njësine e brendshme me pllakën e montimit duke përdorur 2 vidha të montimit të njësies së brendshme M4×12L (aksesor).

9 Instalimi i përshtatësit uajrles LAN

9 Instalimi i përshtatësit uajrles LAN

- Përshtatësi uajrles LAN është pjesë qeses së aksesoreve.

9.1 Instalimi i përshtatësit




RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

- Fikni furnizimin me energji para instalimit të përshtatësit.
- MOS e përdorni përshtatësin me duar të lagura.
- MOS e lini përshtatësin të laget.
- MOS e çmontoni, modifikoni apo riparoni përshtatësin.
- Kapni lidhësin kur shkëputni kordonin e lidhjes.
- FIKNI energjinë në rast se dëmtohet përshtatësi.


9.1.1 Për të lidhur përshtatësin me njësinë

- 1 Hiqni ngjitësen që mban lidhësin e kordonit të lidhjes.




a Ngjitëse

- 2 Prisni kapësen dhe hiqni lidhësin nga mbështjellësja mbrojtëse.




a Mbështjellësja mbrojtëse
b Kapësja

- 3 Hiqni kasën e sipërme të përshtatësit uajrles LAN.




a Kutia e sipërme
b Qarku i stampuar i përshtatësit uajrles LAN
c Kutia e poshtme

- 4 Bashkoni lidhësin e kordonit të lidhjes (i bardhë).




a Lidhësi

- 5 Shtrëngoni kordonin e lidhjes me çarjen në kasën e përshtatësit (e poshtme). Sigurohuni që të mos transmetohet forca e jashtme.
- 6 Këputni majën e kasës së sipërme në kapësen në krye të kasës së sipërme dhe shtypni për të mbyllur kutinë.




- 7 Fiksoni kasën e përshtatësit të sipërm me 2 vida (aksesor).




9.1.2 Vendosni përshtatësin në njësi

- 1 Vendosni përshtatësin uajrles LAN në çengela.




- 2 Mbylli përshtatësin duke e shtypur për poshtë.



- 3 Për të hequr përshtatësin, kryeni hapat e instalimit në rend të kundërt.

9.1.3 Kontrollimi i funksionalitetit të përshtatësit

- 1 Ndizni energjinë dhe kontrolloni që llamba RUN e produktit vezullon.



9.2 Rregullimi i LAN-it me valë

Klienti mban përgjegjësi për të ofruar:

- Telefon inteligjent ose tablet me versionin minimal të mbështetur të Android ose iOS, përcaktuar në app.daikineurope.com
- Linjë interneti dhe pajisje komunikimi si modem, ruter etj.
- Pikë aksesit linje LAN uajrles.
- Aplikacion i instaluar falas ONECTA.

9.2.1 Instalimi i aplikacionit ONECTA

- Shkoni te Google Play (për pajisjet Android) ose App Store (për pajisjet iOS) dhe kërkoni "ONECTA".
- Ndiqui udhëzimet në ekran për të instaluar aplikacionin ONECTA.



INFORMACION

Skanoni kodin QR për të shkarkuar dhe instaluar aplikacionin ONECTA në telefonin tuaj celular ose tablet:



10 Konfigurimi



INFORMACION

Në rast se në 1 dhomë instalohen 2 njësi të brendshme, caktoni adresën të ndryshme për 2 ndërfaqe përdoruesi. Për procedurë referojuni udhëzuesit referencë të instaluesit, kurse për vendndodhje shikoni "1.1 Rreth këtij dokumenti" [p. 6].

11 Vënia në punë



NJOFTIM

Lista e plotë e komisionimit të përgjithshëm. Përkrah udhëzimeve të komisionimit në këtë kapitull, disponohet gjithashtu një listë e plotë e komisionimit të përgjithshëm në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

Lista e plotë e komisionimit të përgjithshëm është plotësuese e udhëzimeve në këtë kapitull dhe mund të përdoret si udhëzim dhe shabllon raportimi gjatë komisionimit dhe dorëzimit të përdoruesit.



NJOFTIM

GJITHMONË përdorni njësinë me rezistorët elektrikë dhe/ose sensorët/çelësat e presionit. Nëse JO, mund të ndodhë dëgjia e kompresorit.

11.1 Lista e plotë para komisionimit

- Pas instalimit të njësisë, kontrolloni artikujt e renditur më poshtë.
- Mbyllni njësinë.
- Ndizni njësinë.

☐	Lexo udhëzimet e instalimit të plotë, siç përshkruhen në udhëzuesin e instaluesit të referimit .
☐	Njësitë e brendshme janë montuar siç duhet.
☐	Njësia e jashtme është montuar siç duhet.
☐	Hyrja/dalja e ajrit Kontrolloni që hyrja dhe dalja e ajrit nga njësia NUK pengohet nga letra, kartoni apo ndonjë material tjetër.
☐	NUK ka faza që mungojnë apo që kthehen mbrapsht .
☐	Tubat e ftohësit (të gazit dhe lëngut) janë të izoluar termikisht.
☐	Kullimi Sigurohuni që kullimi qarkullon pa probleme. Pasoja e mundshme: Uji i kondensuar mund të pikojë.
☐	Sistemi është tokëzuar siç duhet dhe terminalet e tokëzimit janë shtrënguar.
☐	Signuresat ose pajisjet e mbrojtjes të instaluar lokalisht vendosen në përputhje me këtë dokument dhe NUK kanë kaluar në rrugë anësore.
☐	Voltazhi i furnizimit me energji elektrike përputhet me voltazhin në etiketën identifikuese të njësisë.
☐	Telat e specifikuar përdoren për kabllon e ndërlidhjes .
☐	Njësia e brendshme merr sinjale të ndërfaqes së përdoruesit.
☐	NUK ka lidhje të lira ose përbërës të dëmtuar elektrikë në kutinë e çelësit.
☐	Rezistenca e izolimit të kompresorit është NË RREGULL .
☐	NUK ka përbërës të dëmtuar ose tuba të ngjeshur në pjesën e brendshme të njësive të brendshme dhe jashtme.
☐	NUK ka rrjedhje të ftohësit .
☐	Madhësia e duhur e tubit instalohet dhe tubat izolohehen siç duhet.
☐	Valvulet e ndalimit (gazit dhe lëngjeve) në njësinë e jashtme janë plotësisht të hapura.

11.2 Kryerja e një testimi

Kushti paraprak: Energjia elektrike DUHET të jetë brenda rrezes së specifikuar.

Kushti paraprak: Ekzekutimi i testimit mund të kryhet në gjendje ftohjeje ose ngrohjeje.

Kushti paraprak: Referojuni manualit të përdorimit të njësishë së brendshme për të caktuar temperaturën, modalitetin e operimit....

- 1 Në gjendjen ftohje, zgjidhni temperaturën më të ulët të programuar. Në gjendje ngrohje, zgjidhni temperaturën më të lartë të programuar. Ekzekutimi i testimit mund të çaktivizohet nëse është e nevojshme.
- 2 Kur të mbarojë ekzekutimi i testimit, caktoni temperaturën në një nivel normal. Në gjendje ftohje: 26~28°C, në gjendje ngrohje: 20~24°C.
- 3 Sigurohuni që të gjitha funksionet dhe pjesët funksionojnë si duhet.
- 4 Sistemi ndalon së operuari 3 minuta pas FIKJES së njësishë.

11.2.1 Kryerja e një ekzekutim testimi në sezonin e dimrit

Kur e përdorni kondicionerin në gjendjen e Ftohjes në dimër, kalojeni në operimin e ekzekutimit të testimit duke përdorur metodën vijuese.

- 1 Shtypni njëkohësisht , dhe .
 - 2 Shtypni .
 - 3 Zgjidhni 7°.
 - 4 Shtypni .
 - 5 Shtypni për të ndezur sistemin.
- Rezultati:** Operimi i ekzekutimit të testimit ndalon automatikisht pas 30 minutave.
- 6 Për të ndaluar operimin, shtypni .

INFORMACION

Disa nga funksionet NUK MUND të përdoren në gjendjen e operimit të ekzekutimit të testimit.

Nëse gjatë përdorimit ndodh një avari e energjisë, sistemi rifillon automatikisht menjëherë pas rikthimit të energjisë.

12 Hedhja

NJOFTIM

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

13 Të dhënat teknike

- Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- **Grupi i plotë** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

13.1 Skema e instalimeve elektrike

Skema e instalimeve elektrike jepet bashkë me njësishë, e cila gjendet në anën e brendshme djathtas të grilës së përparme të njësishë së brendshme.

13.1.1 Legjenda e unifikuar e skemës së instalimeve elektrike



Për pjesët dhe numërimin e zbatuar, referojuni skemës së rrjetit të telave në njësi. Numërimi i pjesëve bëhet me numra arabikë sipas rendit ngjitës për secilën pjesë dhe përfaqësohet te pasqyra poshtë nga "*" te kodi i pjesës.



Simboli	Kuptimi	Simboli	Kuptimi
	Çelësi		Tokëzimi mbrojtës
			Tokëzimi mbrojtës (vidhë)
	Lidhja		Detektori
	Lidhësi		Lidhësi i rele-së
	Tokëzimi		Lidhësi me qark të shkurtër
	Instalimet në terren		Terminali
	Siguresa		Ripi i terminalit
	Njësia e brendshme		Kapësja e telit
	Njësia e jashtme		Ngrohësi
	Pajisja reziduale korrenti		

Simboli	Ngjyra	Simboli	Ngjyra
BLK	E zezë	ORG	Portokalli
BLU	Blu	PNK	Rozë
BRN	Kafe	PRP, PPL	E purpurt
GRN	Jeshil	RED	E kuqe
GRY	Gri	WHT	E bardhë
SKY BLU	Blu qielli	YLW	E verdhë

Simboli	Kuptimi
A*P	Qarku i stampuar
BS*	Butoni shtytës NDEZUR/FIKUR, çelësi i operimit
BZ, H*O	Sinjalizuesi
C*	Kondensatori
AC*, CN*, E*, HA*, HE*, HL*, HN*, HR*, MR*_A, MR*_B, S*, U, V, W, X*A, K*R_*, NE	Lidhja, lidhësi
D*, V*D	Dioda
DB*	Ura e diodës
DS*	Çelësi DIP
E*H	Ngrohësi
FU*, F*U, (për karakteristikat referojuni PCB brenda njësishë)	Siguresa
FG*	Lidhësi (baza e kornizës)
H*	Ripi
H*P, LED*, V*L	Llamba e pilotit, dioda që rrezaton dritë
HAP	Dioda që rrezaton dritë (monitori i shërbimit jeshil)
HIGH VOLTAGE	Voltazh i lartë
IES	Sensori inteligjent i syve
IPM*	Modul inteligjent i energjisë
K*R, KCR, KFR, KHuR, K*M	Rele magnetike
L	Me rrymë

Simboli	Kuptimi
L*	Bobinë
L*R	Reaktor
M*	Motori ingranues
M*C	Motori i kompresorit
M*F	Motori i ventilatorit
M*P	Motori i pompës së kullimit
M*S	Motori i lëkundjes
MR*, MRCW*, MRM*, MRN*	Rele magnetike
N	Neutral
n=*, N=*	Numri i kalimeve përmes bërthamës së ferritit
PAM	Rregullimi i gjerësisë së pulsit
PCB*	Qarku i stampuar
PM*	Moduli i energjisë
PS	Ndërimi i energjisë
PTC*	Termistori PTC
Q*	Tranzitori bipolar me portë të izoluar (IGBT)
Q*C	Çelësi
Q*DI, KLM	Çelësi i rrjedhjes së tokëzimit
Q*L	Protektor mbingarkimi
Q*M	Çelësi termal
Q*R	Pajisja reziduale korrenti
R*	Rezistencë
R*T	Termistor
RC	Marrësi
S*C	Çelësi i kufizimit
S*L	Çelësi i pluskimit
S*NG	Detektori i rrjedhjes së ftohësit
S*NPH	Sensori i presionit (i lartë)
S*NPL	Sensori i presionit (i ulët)
S*PH, HPS*	Çelësi i presionit (i lartë)
S*PL	Çelësi i presionit (i ulët)
S*T	Termostat
S*RH	Sensori i lagështisë
S*W, SW*	Çelësi i operimit
SA*, F1S	Mbrojtës i fryrjes
SR*, WLU	Marrësi i sinjalit
SS*	Çelës i përzgjedhësit
SHEET METAL	Pllaka e fiksuar e rripit terminal
T*R	Transformuesi
TC, TRC	Transmetuesi
V*, R*V	Varistori
V*R	Ura e diodës, tranzitori bipolar me portë të izoluar (IGBT) moduli i energjisë
WRC	Telekomanda uajrles
X*	Terminali
X*M	Ripi i terminalit (blloko)
Y*E	Bobinë valvuli e zgjerimit elektronik
Y*R, Y*S	Bobinë valvuli e solenoidit përmbys
Z*C	Bërthamë ferriti
ZF, Z*F	Filtër zhurme







DAIKIN ISITMA VE SOĞUTMA SİSTEMLERİ SAN.TİC. A.Ş.

Gölsuyu Mahallesi, Fevzi Çakmak Caddesi, Burçak Sokak, No:20, 34848 Maltepe

İSTANBUL / TÜRKİYE

Tel: 0216 453 27 00

Faks: 0216 671 06 00

Çağrı Merkezi: 444 999 0

Web: www.daikin.com.tr

Copyright 2023 Daikin

DAIKIN EUROPE N.V.

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

3P748643-3B 2023.10